# Rregullat e Tregtimit

# Rregullat e Tregtimit - Termat e përgjithshme

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike

## I. Tabela e përmbajtjes

1. HYRJE ..... 3
2. INTERPRETIMI, PËRCAKTIMET DHE SHKURTIMET ..... 3
3. KUSHTET PËR TREGTIM ..... 4
4. PËRFAQËSIMI DHE GARANCITË ..... 7
5. KRIJUESIT E TREGUT ..... 9
6. LISTIMI I PRODUKTEVE ..... 9
7. DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME PËR TREGËTIMIN ..... 9
8. TARIFAT DHE PAGESAT ..... 11
9. SJELLJA E TREGUT DHE MBIKQYRJA E TREGUT... 12**ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.**
10. DETYRIMET DHE FORCA MADHORE ..... 12
11. DËMSHPËRBLIMET ..... 13
12. SHËRBIMET E INFORMACIONIT TË TREGUT ..... 14
13. KOMUNIKIMET ..... 14
14. SHTESAT ..... 15
15. TË NDRYSHME ..... 15
16. LIGJI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE ..... 16

## II. Shtojcat e tregtimit

1. Specifikimet e Produktit
2. Tregu injë dite më parë
3. Rregullat e TregtimitIntraday (Brenda ditës)
4. Rregullat e administrimit të Tregut
5. Rregullat e shlyerjeve dhe të Pagesave
6. Rregullat Specifike për Tregtimin e zonave Import-Eksport

## 1. HYRJE

1.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike është e licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për të organizuar dhe operuar Tregun e Ditës më Parë për Energjinë Elektrike në Republikën e Shqipërisë.

1.2 Tregu Shqiptar i Ditës më Parë për energjinë elektrike krijon mundësinë e tregtisë të ditës më parë nëpërmjet një Ankandi, në lidhje me secilën Ditë të shpërndarjes, në bazë të të gjithë ofertave të vëllimit dhe ofertave të çmimit nga ana e anëtarëve, të marra para mbylljes së ankandit përkatës. Dispozita të mëtejshme që rregullojnë Tregtimin në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë, janë përcaktuar në Rregulloren e Tregut Shqiptar të një Dite më parë.

1.3 Tregu Shqiptar i një Dite më parë ofron produkte të tilla për tregti, siç janë përcaktuar në Specifikimet e Produktit (Shtojca 1).

1.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ofron pagesa të transaksioneve, në Tregun Shqiptar të një Dite me Parë.

1.5 Këto Rregulla Tregu aplikohen për të gjithë Tregtitë dhe Pagesat në Tregjet Shqiptare të një Dite më Parë, dhe përbëjnë një marrëveshje ndërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe çdo Anëtari në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë. Rregullat Tregut përfshijnë këto Terma të Përgjithshme dhe gjithë Shtojcat e tyre. Këto Terma të Përgjithshme janë të detyrueshme dhe me të njëjtën fuqi ligjore. Këto Rregulla Tregtare janë gjithashtu të drejtuara nga legjislacioni sekondar Shqiptar i aplikuar, Modeli Shqiptar i Tregut dhe Rregullat e Tregtimittë aplikueshme.

1.6 Të gjitha transaksionet e regjistruara në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë do të jenë automatikisht dhe me mënyrë të detyrueshme objekt për pagesat, ku anëtarët do të bëhen Kundrapalë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, që veprojnë si kundërpalë qëndrore në të gjitha Transaksionet, ashtu siç edhe është përcaktuar më tej në Rregullat e Pagesave dhe Shlyerjeve (Shtojca 5).

## 2. INTERPRETIMI, PËRKUFIZIMET DHE SHKURTIMET

2.1 Termat e përdorur në këto Rregulla, do të kenë kuptimin e përcaktuar në Shtojcën e Rregullave të Tregut 1 (Përkufizimet) ose siç përcaktohet në mënyrë specifike në tekstin eRregullave të Tregut 1.

2.2 Referencat në cilindo ligj ose statut do të konsiderohen të përfshijnë çdo amendim të lidhur, konsolidime, ri-ratifikime ose zëvendësimet e tij.

2.3 Referencat ndaj një njësie ekonomike përfshijnë çdo koorporatë, një organizatë të painkorporuar ose çdo subjekt tjetër juridik apo person fizik.

2.4 Referencat ndaj një Anëtari do të konsiderohen të përfshijnë referencat për pasardhësit ose të caktuarit (të menjëhershëm ose ndryshe) të atij Anëtari.

2.5 Referencat ndaj pikave në kohë i referohen Kohës Evropiano Qendrore (formati 24-orësh), përveç kur përcaktohet ndryshe.

2.6 Çdo fjalë që prezanton njësinë do të pranojë shumësin kur konteksti e pranon dhe anasjelltas. Çdo fjalë që prezanton gjininë asnjanëse do të përfshijë edhe gjininë femërore dhe gjininë mashkullore (në lidhje me një person fizik).

2.7 Termi “Përfshirë” do të ketë kuptimin “Përfshirë por jo i kufizuar në”.

2.8 Çdo referencë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, që ka të drejtë të marrë një vendim ose ndërprerjen apo të formojë çfarëdo opinioni apo gjykimi, do të ketë kuptimin, përveç nëse përcaktohet ndryshe, se Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka të drejtë të ushtrojë gjykimin e vetë ekskluziv dhe të papenguar për ta bërë këtë.

2.9 Titujt në këto Rregulla Tregu janë vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë interpretimin e saj.

2.10 Referencat lidhur me komunikimet me shkrim do të përfshijnë, përveç kur përcaktohet ndryshe, komunikimin me e-mail dhe të komunikimit përmes ETS (Sistemi i Telefonisë Elektronike).

2.11 Në rastin e konfliktit ndërmjet këtyre Termave të Përgjithshme dhe Rregullave të Tregut Shqiptar të një Dite më Parë të përfshira në Shtojcën Tregtare 2, dispozitat e rregullave në fuqi të tregut të caktuara në Shtojcën tregtare 2 do të prevalojnë. Në rast të konfliktit ndërmjet këtyre Rregullave Tregtare ose ndonjë prej shtojcave të saj Tregtare në njërën anë dhe një marrëveshje tregtare të lidhur në anën tjetër, dispozitat e një marrëveshjeje të tillë do të prevalojnë.

## 3. KUSHTET PËR TREGTIM

### 3.1 Parakushtet për Tregtim

3.1.1 Subjektet të cilët dëshirojnë për të kryer Tregti në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë, duhet të hyjnë në një Marrëveshje për Anëtarësim me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, të jenë të ligjshëm si Kundërpalë në Rregullat e Pagesave dhe Likujdimeve dhe duhet të kenë të drejtën për të marrë pjesë në Tregun Shqiptar të Energjisë Elektrike sipas Ligjit Shqiptar të aplikuar që rregullon tregun e energjisë elektrike, përpara fillimit të Tregtimit të Tregut Shqiptar të një Dite më Parë.

3.1.2 Në vazhdim të kërkesave në Nenet 3.1.1, secili Anëtar në çdo kohë duhet të:

a. jetë i ligjshëm si Kundërpalë kundrejt çdo Transaksioni dhe Transaksionit korrespondues të Pagesës, në perputhje me Rregullat e Pagesave dhe Shlyerjeve;
b. të përftojnë, të mirëmbajnë dhe të pajtohen me të gjitha licencat, autorizimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga ligji në fuqi, për të mundësuar atë të kryejë Tregtinë në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë dhe të përmbushë detyrimet e tij sipas Rregullores së Tregtimit;
c. caktojë një përgjegjës për Tregtinë, në përputhje me Paragrafin 3.3.

3.1.3 Anëtarët duhet në emër të tyre ose nëpërmjet një Furnizuesi të kenë hyrë në një marrëveshje për përgjegjësinë për balancimin me palën përkatëse përgjegjëse për balancimin ose me Operatorin e Sistemit të Transmetimit. Nëse një marrëveshje e tillë është ndërprerë ose pezulluar, Anëtari ose Përfaqësuesi i Klientit, do të njoftojë menjëherë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mundet në raste të tilla të pezullojë dhe të ndërpresë Marrëveshjet për Anëtarësimin.

3.1.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kërkojë që një Anëtar të ofrojë konfirmimin e marrëveshjes së tij me një Furnizues

3.1.5 Të drejta dhe detyrime të mëtejshme mbi Anëtarët përsa i përket Tregtisë, janë përcaktuar në Marrëveshjet e Tregtisë dhe Rregullat e Drejtimit të Tregut (Shtojca 4) sipas rastit.

## 3.2 Aprovimi i Anëtarëve

3.2.1 Subjektet që dëshirojnë të hyjnë në një Marrëveshje Anëtarësimi, duhet të dërgojnë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike një aplikim me shkrim për anëtarësim në atë formë që do ta përshkruajë herë pas here Bursa Shqiptare e Energjisë.

3.2.2 Si pjesë e procedurës së aprovimit, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kërkojë informacion shtesë nga aplikanti mbi statusin ligjor të aplikantit, saktësinë financiare, organizimin, sistemet teknike, nivelin e experiencës dhe kompetencës dhe çështje të tjera relevante për vlerësimin nëse është apo jo Aplikanti i përshtatshëm dhe i duhur për tu bërë Anëtar.

3.2.3 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund t’i kërkojë një aplikanti që të ofrojë një arsyetim bindës ligjor në ato çështje që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike i konsideron të arsyeshme, duke marrë parasysh që aplikanti ka ligjërisht të drejtën dhe është i autorizuar për të ushtruar Tregtinë në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë dhe që Marrëveshja e Tregtisë ka qenë firmosur nga një përfaqësues i caktuar në mënyrë të rregullt.

3.2.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të lejojë vetëm aplikantët që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sipas gjykimit të saj, i konsideron të përshtatshëm dhe të duhur për

t'u bërë Anëtarë. Aplikantët nuk do të refuzohen në mënyrë të paarsyeshme. Në rast të refuzimit të një aplikanti, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të japë një deklaratë me shkrim për arsyet.

3.2.5 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të pranojë dhe trajtojë përgjithësisht aplikantë dhe Anëtarë mbi baza të ndershme dhe jodiskriminuese. Subjekt i këtij principi të sipërpërmendur, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të imponojë termat dhe kushtet mbi subjektet individuale nëse kjo, sipas mendimit të arsyeshëm të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, është e domosdoshme të reflektojë rrethanat e veçanta që zbatohen për atë subjekt, ose të pranojë një subjekt, i cili do të përjashtohet në të kundërt nga Anëtarësimi, përfshirë termat dhe kushtet e kërkuara nga Ligji në fuqi në juridiksionin ku subjekti është i regjistruar.

3.2.6 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të informojë menjëherë aplikantin, me shkrim, mbi rezultatin e procesit të aplikimit. Nëse aplikimi aprovohet, një kopje origjinale e marrëveshjes e nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të nënshkruesit dhe Bursës Shqiptare do t'u vihet në dispozicion palëve.

### 3.3 Përgjegjësit për Tregtimin dhe Tregtarët.

3.3.1 Çdo Anëtar duhet të emërojë një Përgjegjës për Tregtinë e Anëtarit, subjekt ky për aprovim nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, që nuk duhet të refuzohet pa arsye.

3.3.2 Çdo Anëtar mund të emërojë Tregtare shtesë si të autorizuar për të kryer tregtinë në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë, subjekt ky aprovimi nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, që nuk duhet të refuzohet pa arsye.

3.3.3 Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, Përgjegjësi për Tregtinë dhe Tregtarët do të kenë akses të plotë në Sistemin për Tregtinë Elektronike (STE) përsa i përket të gjitha Portofoleve të Tregtisë së Anëtarit. Çdo Anëtar do të sigurojë që Përgjegjësi i tij për Tregtinë, dhe Tregtarët do të jenë plotësisht të autorizuar për të përfaqësuar Anëtarin kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në të gjitha çështjet që lidhen me Tregtinë e Anëtarit dhe do të jetë në gjendje të marrë një veprim të tillë në një mënyrë konsistente me programet e përditshme kohore dhe kërkesa të tjera të vendosura nga ose në pajtim me Rregullat e Tregtimit.

3.3.4 Pas marrjes nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike të një njoftimi me shkrim nga Anëtari se emërimi i çdo individi si tregëtari përgjegjësi dhe/ose Tregtari do të revokohet, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të pezullojë menjëherë aksesin në ETS të Përgjegjësit për Tregtinë dhe/ose Tregtarit, dhe do të dërgojë një konfirmim me shkrim. Pavarësisht këtij njoftimi, Anëtari do të mbetet i detyruar dhe përgjegjës për të gjitha

veprimet ose mosveprimet e Anëtarit në lidhje me Tregtinë gjatë periudhës që Përgjegjësi për Tregtinë dhe/ose Tregtari ka akses në STE, deri në kohën kur Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike të ketë konfirmuar me shkrim që aksesi në STE, Përgjegjësit për Tregtinë dhe/ose Tregtarit është ndërprerë.

3.3.5 Në rastin kur Përgjegjësi për Tregtinë dhe/ose Tregtari është pezulluar, Anëtari duhet të emërojë një person të ri sipas kushteve sipas pikave 3.3.1.dhe 3.3.2.brenda 5 (pesë) ditëve që kur personi i mëparshëm u pezullua.

### 3.4 **Portofolet e Tregtisë**

3.4.1 Anëtarëve, subjekt aprovimi paraprak nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (aprovimi nuk mund të refuzohet pa arsye) do t'u lejohet numri i Portofoleve tregtare të kërkuara prej tyre nga Tregu Shqiptar i një Dite më Parë, sipas rastit. Portofolet e Tregtisë janë subjekt i pagesave siç janë të përcaktuara në Programin Tarifor.

## 4. PËRFAQËSIMI DHE GARANCITË

### 4.1 **Përfaqësimi nga Anëtari**

4.1.1 Secili Anëtar përfaqëson dhe garanton kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në çdo datë në të cilën një Porosi është paraqitur ose Transaktion ka hyrë në të:

a. **Autoriteti.** Ka autoritetin të kryejë detyrimet e veta në përputhje me Rregullat e Tregtimit dhe çdo Transaksion,

b. **Statusi.** Është I organizuar dhe ekziston në mënyrë të rregullt sipas ligjeve dhe juridiksionit mbi shoqëritë tregtare

c. **Organizata.** Ka personelin dhe organizimin e duhur për të mundësuar që të performojnë me sukses dhe personeli i vetë ka kompetencën dhe dijen e domosdoshme për Tregtinë;

d. **Ndërmarrja e rrezikut.** Ai është i vetëdijshëm dhe kupton karakteristikat e secilit prej produkteve dhe rreziqet që lidhen me to, si dhe ka paraqitur urdhëra pas një mundësie të plotë për të rishikuar termat dhe kushtet e tyre, dhe ka një kuptim adekuat të këtyre termave dhe kushteve dhe të rreziqeve të tyre, dhe është i aftë për ndërmarrjen e këtyre rreziqeve;

e. **Asnjë Shkelje apo Konflikt.** Ekzekutimi, shpërndarja dhe përmbushja e Marrëveshjeve përkatëse Tregtare apo Rregullat Tregtare, nuk shkelin apo konfliktojnë me asnjë Ligj në Fuqi apo ndonjë dispozitë të dokumenteve kushtetuese në fuqi të Anëtarit apo ndonjë nga pasuritë e tij, ose ndonjë kufizim kontraktual të detyrueshem ose që ndikon te ai apo në ndonjë nga pasuritë e tij**;**

f. **Autorizimet e Kërkuara**. Të gjitha Autorizimet e kërkuara sipas Legjislacionit në fuqi, janë marrë dhe janë në fuqi, dhe është përmbushur çdo kusht i autoriteteve, dhe nuk ka më nevojë për licencë apo dokumente apo akte të tjera që kanë nevojë të merren nga

anëtari në përputhje me çdo organ rregullator ose Gjykatën me qëllim tregtimin dhe pagesën.

g. **Informacioni i Saktë.** Të gjitha informacionet e zbatueshme, që dërgohen me shkrim nga ose në emër të Anëtarit i cili është identifikuar si i nënshtruar ndaj apo i lidhur me Rregullat Tregtare është që nga data që është e dërguar në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, i vërtetë, i saktë dhe i plotë në çdo aspekt material; dhe

h) **Pajtueshmëria. N**gjarje e pa-pajtueshme, apo ngjarje që me njoftimin apo me kalimin e afatit apo me të dyja do të përbënte një Ngjarje të pa- pajtueshme ka ndodhur lidhur me të, dhe një ngjarje e tillë nuk mund të ndodhë si rezultat i saj, që hyn në, apo që përmbush detyrimet e veta në përputhje me Rregullat e Tregtisë.

4.1.2 Anëtari kur bën Tregti mund, të përsërisë kushtet e specifikuara më sipër ashtu si edhe çdo kusht tjetër të specifikuar si të tillë në Rregullat e Tregtimit.

4.1.3 Anëtari pranon që është në detyrën e tij të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike me shkrim në rast të ndonjë shkelje apo dyshimi për shkelje të përfaqësimit të tij, menjëherë pasi Anëtari bëhet i vetëdijshëm për të njëjtën gjë.

4.2 **Përfaqësimet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike**

4.2.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike përfaqëson dhe garanton për secilin Anëtar në lidhje me çdo Transaksion i cili ka hyrë në Sistemin e saj STE – Sistemin e Tregtisë Elektronike që:

a) **Autoriteti**. Ka autoritetin të kryejë detyrimet e veta në përputhje me Rregullat e Tregtimitdhe çdo Transaksion,

b) **Statusi**. Është I organizuar dhe ekziston në mënyrë të rregullt sipas ligjeve dhe juridiksionit mbi shoqëritë tregtare;

c) **Organizata**. Ka personelin dhe organizimin e duhur për të mundësuar që të performojnë me sukses dhe personeli i vetë ka kompetencën dhe dijen e domosdoshme për Tregtinë;

d) **Asnjë Shkelje apo Konflikt**. Ekzekutimi, shpërndarja dhe përmbushja e Marrëveshjeve përkatëse Tregtare apo Rregullave Tregtare, nuk shkelin apo konfliktojnë me asnjë Ligj në Fuqi ose ndonjë dispozitë të dokumenteve kushtetuese në fuqi të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike apo të ndonjë nga pasurive të saj, ose ndonjë kufizim kontraktual të detyrueshëm ose që ndikon te ajo apo ndonjë nga pasuritë e saj;

e) **Autorizimet e kërkuara**. Të gjitha Autorizimet e kërkuara sipas Ligjit në Fuqi janë marrë dhe janë në fuqi të plotë dhe është në përputhje me kushtet e çdo autorizimi të kërkuar dhe nuk ka më licenca, dokumenta apo akt tjetër sa i përket Organit Rregullator apo Gjykatës që kërkohet të merret, të bëhet, nga Bursa Shqiptare e energjisë, në përputhje me aktivitetin e saj, sipas rregullave të tregtimit.

f) **Informacioni i Saktë**. Të gjitha informacionet e zbatueshme, që dërgohen me shkrim nga ose në emër të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, e cila është identifikuar si e nënshtruar ndaj apo e lidhur me Rregullat Tregtare është, që nga data që ju janë dërguar Anëtarëve dhe, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në informacionin në fuqi, i besuar se është i vërtetë dhe i saktë, i plotë në çdo aspekt materjal; dhe

g) **Pajtueshmëria**. Asnjë mospagesë, apo ngjarje që me njoftimin apo me kalimin e afatit apo me të dyja do të përbënte një mospagesë, s’ka ndodhur lidhur me të dhe asnjë ngjarje e tillë nuk mund të ndodhë si rezultat i saj, që hyn në, apo që përmbush detyrimet e veta në përputhje me Rregullat e Tregtisë.

## 5. KRIJUESIT E TREGUT

5.1.1 Një Anëtar mund të aplikojë pranë Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike për tu aprovuar si Krijues Tregu në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë. Nëse Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike e aprovon emërimin e Anëtarit si Krijues Tregu, Anëtari do të hyjë në një Marreveshje për Krijimin e Tregut me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

5.1.2 Të drejtat dhe detyrimet e Krijuesve të Tregut janë më tej të specifikuara në Marrëveshjen individuale të Krijuesit të Tregut.

## 6. LISTIMI I PRODUKTEVE

6.1.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike vendos cili Produkt do të listohet apo hiqet nga Tregu Shqiptar i një Dite më Parë, duke ndjekur konsultimet me Bordin Këshillimor të Klientëve

## 7. DISPOZITAT E PËRGJITHESHME MBI TREGTINË

### 7.1 Objektet e Tregtisë

7.1.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mirëmban një sistem tregimi elektronik (STE), përkatësisht Web-i i një Dite më Parë, një sistem telefonik tregtimi (TTS).

7.1.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike lehtëson Tregtinë e Produkteve ndërmjet Anëtarëve duke marrë porosi në STE dhe përcakton vëllimet dhe çmimet që tregtohen sipas

rregullave prevaluese për llogaritjet e çmimeve. Një anëtar mundet në çdo Ditë Tregtie, brenda orëve të Tregtisë për Produktin përkatës, të paraqesë porosi nëpërmjet Sistemit Elektronik të Tregtisë. Përpunimi dhe përputhja e Porosive dhe Transaksionet i nënshtrohet rregullave të zbatueshme për Tregun Shqiptar të një Dite më Përpara.

7.1.3 Anëtarët janë përgjegjës për ngritjen e komunikimit elektronik me Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, në përputhje me specifikimet e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.

7.1.4 Tregetia në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë është anonime, me përjashtim asaj ndërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe Anëtarit Individual që fut një porosi dhe si konseguencë e kësaj, futet kështu në një Transaksion. Përveç rasteve kur është e nevojshme për të shfaqur Porositë dhe Transaksionet për Anëtarët, në përputhje me këtë nen 7.1.4 apo ose siç përcaktohet ndryshe në nenin 12 të këtyre Rregullave të Tregtisë, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të trajtojë të gjithë Porositë dhe informacionin tjetër nga Anëtarët, që i kanë komunikuar Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në lidhje me Transaksionet si konfidencial. Kjo nuk shmang detyrimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike që, sipas ligjit në fuqi të ofrojë informacion ndaj Autoriteteve Rregullatore ose organeve të tjera, me përgjegjësinë e vetë ose me kërkesë të tyre.

7.1.5 Të gjithë Porositë dhe Transaksionet në STE do të ruhen elektronikisht dhe mbahen nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në përputhje me Ligjin në Fuqi. Informacioni I Transaksioneve që rezulton nga këto rekorde mund të përdoret ashtu siç është specifikuar në Nenin 12. Të gjitha telefonatat me Tabelën e Recepsionit të Tregtisë dhe TTS mund të rregjistrohen e ruhen në përputhje me Ligjin në Fuqi. Të dy palët: Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe Anëtarët japin pëlqimin për rregjistrime të tilla dhe ndërmarrin sigurimin e çdo pëlqimi të nevojshëm nga punonjësit e tyre, me qëllim që të përputhet me Ligjin në Fuqi.

## 7.2 Sistemi i Tregtisë Elektronike (STE, Web-i i një Dite më Parë)

7.2.1 STE është mjeti kryesor i tregtisë për të gjithë Anëtarët që dëshirojnë të kryejnë Tregti në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë. Anëtarët mund të rregjistrojnë porositë e tyre në STE, ku Porositë janë renditur dhe përputhuar sipas rregulloreve për Tregun Shqiptar të një Dite më Parë.

7.2.2 Aksesi në STE për Anëtarët është jo-ekskluziv dhe i pa-transferueshëm. Anëtarët do të kenë të drejtën e aksesit dhe përdorimit të STE me kusht që:

a. Anëtari plotëson kushtet për Tregtinë, siç është specifikuar në nenin 3.1.

b. Anëtari që nuk ka të drejtat e tij të Tregtisë, është pezulluar apo terminuar në përputhje me këto rregulla Tregtimi; dhe

c. Përputhshmëria e Anëtarit me termat e përdorimit të STE-së është ashtu siç është specifikuar në këto Rregulla Tregtimi.

7.2.3 Rregjistrimi i Porosive dhe Transaksioneve në STE është i kushtëzuar nga të pasurit e të drejtës së Anëtarit për të bërë pagesa, në përputhje me Rregullat e Pagesave.

### 7.3 Sistemi Telefonik i Tregtisë (STT)

7.3.1 TTS përdoren si një mjet backup-i (kopjeje rezervë) për Anëtarët e Tregut Shqiptar të një Dite më Parë. Në kushtet kur STE nuk punon, apo Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike për arsye të tjera mendon se STT është një opsion me praktik se STE, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mundet nën vendimmarrjen e vetë të aprovojë që, Anëtari mund të telefonojë për porositë e tij apo ndryshimet apo anullimet e Porosive, nga telefoni në STT.

7.3.2 Vetëm Tregtarët e aprovuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në përputhje me Nenin 3.3, janë të autorizuar të kontaktojnë STT. Kur kontakton STT, Tregtari duke qenë se është një telefonatë spontane e paprogramuar, duhet në çdo rast, në bazë të kërkesës nga ana e operatorit të STT, të identifikojë vehten me emrin e plotë dhe cilin Anëtar ai përfaqëson, shtetin nga vjen telefonata me dorëzimin e porosisë, dhe pse Anëtari nuk ka mundësi ta dërgojë porosinë e vetë me anë të STE.

7.3.3 Me kusht që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike të miratojë përdorimin e STT, Anëtari duhet të sigurojë një informacion të tillë siç do të kërkohet në qoftë se duke përdorur STE, dhe përveç kësaj të gjitha informacionet e tilla të cilat Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme të mundësohet që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ta regjistrojë me saktësi Urdhrin.

7.3.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të rregjistrojë Porosinë nga STT në STE sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së Porosisë, dhe në rast të disa Porosive në të njëjtën kohë, do të përpiqet për të regjistruar Porositë e marra në të njëjtën sekuencë, pasi Porositë të jenë njoftuar në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

7.3.5 Një Porosi e dërguar përmes STT konsiderohet e rregjstruar vetëm atëherë kur Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka konfirmuar hyrjen e Porosisë në STE përms STT, ose në të kundërt me shkrim. Porosia bëhet e detyrueshme mbi Anëtarin nga koha e rregjistrimit pavarësisht kohës së konfirmimit.

7.3.6 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të bëjë përpjekje komercialisht të aresyeshme për të drejtuar një shërbim STT efektiv dhe të mirëmbajë vazhdimësinë e aksesit në STT, por STT ofrohet mbi një bazë "si në dispozicion" dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk bën asnjë përfaqësim ose garanci përsa i përket disponueshmërisë së STT

për çdo anëtar, në çdo kohë të dhënë.

7.4 **Disponibiliteti i Tregtarëve**

7.4.1 Pasi një Tregtar ka dërguar një Porosi, Tregtari i Anëtarit në fuqi duhet të jetë i disponueshëm për tu kontaktuar me telefon në çdo kohë, për aq kohë sa Porosia të jetë në fuqi. Porositë në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë konsiderohen si valide derisa ankandi përkatës të përfundojë apo Porosia të revokohet në përputhje me Rregullat e Tregtimit.

7.4.2 Kurdoherë që një Anëtar ka hyrë në një Transaksion në përputhje me Rregullat e Tregtimit, Tregetari përkatës do të jetë i disponueshëm me telefon për një periudhë prej tridhjetë (30) minutash pas Kohës së Kontratës në fuqi.

7.5 **E drejta për të refuzuar Porositë**

7.5.1 Pavarësisht çdo dispozite tjetër në Rregullat e Tregtimit, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike rezervon të drejtën, sipas gjykimit të saj, dhe pa njoftim paraprak për një Anëtar të refuzoje, të anulojë apo të refuzojë të shfaqë ose përputhë çdo Porosi e cila në përcaktimin Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike do ti kundërvihej Rregullave Tregtare ose Ligjit në fuqi. Çdo vendim i tillë duhet të jetë i bazuar në mënyrë të arsyeshme, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të njoftojë menjëherë Anëtarin për një vendimi të tillë.

## 8. TARIFAT DHE PAGESAT

8.1 Tarifat kohë pas kohe do të ngarkohen mbi Anëtarët dhe do të faturohet në përputhje me planin tarifor. Përveçse kur siç thuhet në mënyrë eksplicite, të gjitha pagesat janë përcaktuar ekskluzivisht nga TVSH.

8.2 Vetëm nëse parashihet ndryshe në Rregullat e Pagesave dhe të Shlyerjeve, çdo anëtar është përgjegjës dhe do të paguajnë çdo dhe të gjitha TVSH-të dhe taksat përkatëse që dalin në lidhje me aktivitetet e veta Tregtare dhe e cila duhet të paguhet nga ai Anëtar në bazë të Ligjit në fuqi, pa pagesë të mëtejshme, rimbursimin ose dëmshpërblim kundrejt ose nga Anëtari tjetër për një Transaksion apo Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, pavarësisht nëse Anëtari kërkohet bazuar në Ligjin në fuqi të paguajë ndonjë TVSH apo takse përkatëse, e cila është siç duhet për llogarinë e Anëtarit tjetër ose Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

8.3 Shlyerja e tarifave do të kryhet nëpermjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, në përputhje me Rregullat e Pagesave dhe të Shlyerjeve dhe do të përfshihet në Shlyerjen e Transaksionit (eve) korresponduese. Pas kryerjes së pagesës në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të të shkarkojë pretendimin e

saj përkatës kundrejt Anëtarit.

## 9. DREJTIMI I TREGUT DHE MBIKQYRJA E TREGUT

9.1 Anëtarët duhet në çdo kohë të jenë në përputhje me dispozitat e Rregullave të Drejtimit të Tregut kur Tregtojnë. Mospërputhshmëria me Rregullat e Drejtimit të Tregut mund të dënohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në përputhje me dispozitat e Rregullave të Drejtimit të Tregut.

9.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të monitorojë, nëpërmjet Mbikëqyrjes së Tregut, Tregun Shqiptar të një Dite më Parë, me një pikëpamje për tu siguruar, që të gjitha Tregtitë dhe aktivitetet e tjera në Tregun Shqiptar të një Ditë më Parë, janë në përputhje me Rregullat e Drejtimit të Tregut dhe Ligjin në fuqi. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, mund të kryejë investigime mbi aktivitetet e Anëtarëve të Tregut, ashtu siç është specifikuar në Rregullat e Drejtimit të Tregut.

9.3 Mbikqyrja e Tregut e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike mund të bëjë kërkesë për dhe të mbledhë informacion nga anëtarët në lidhje me biznesin e tyre. Biznese të tilla përfshijnë të gjitha Tregtitë fizike dhe financiare.

9.4 Në lidhje me investigimet për biznesin e Anëtarëve, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund, drejtpërsëdrejti nga Pala Përgjegjëse për Balancimin apo nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, të mbledh çdo të dhënë lidhur me manaxhimin, tregun dhe shlyerjen e llogarive.

## 10. DETYRIMET DHE FORCA MADHORE

10.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk do të jetë përgjegjëse për çdo humbje apo dëmtim kundrejt Anëtarit të shkaktuar nga vendimet e biznesit të Anëtarit lidhur me Tregtinë në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë. Pritet që Anëtari të drejtojë Tregtinë në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë me vëmendjen e duhur që kërkohet nga një biznesmen i mire.

10.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në asnjë rrethanë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë humbje ose dëmtim të një Anëtari, të shkaktuar nga një veprim ose mosveprim prej një tjetër Anëtari.

10.3 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk do të jetë përgjegjës për asnje humbje apo dëmtim të një Anëtari, që mund të lindi nga Tregtia apo nga Rregullat e Tregtisë si rezultat i ndonjë veprimi apo mosveprimi nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ose ndonjë Anëtar tjetër, me kusht që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk ka vepruar pakujdesisht, pandershmërisht (mashtrim) ose duke mos paguar me paramendim.

10.4 Me përjashtim të rastit kur Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka vepruar pandershmërisht

apo është në rast mospagese të paramenduar, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike nuk do të jetë përgjegjëse në asnjë rrethanë kundrejt Anëtarit për humbjen indirekte dhe për dëmtimin si pasojë e kësaj, përfshirë humbjen e fitimit apo kontratave.

10.5 Pavarësisht nga nenet 10.1 dhe 10.2 një Anëtar do të jetë përgjegjës kundrejt Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike për të gjitha humbjet apo dëmtimet e pësuara, përfshirë shpenzimet e akumuluara, që rezultojnë drejtpërdrejt nga mospagimi i Anëtarit, si pasoje e një mosrealizimi.

10.6 As Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike as Anëtari nuk do të jenë përgjegjës nën çfarëdolloj rrethane për ndonjë humbje apo dëmtim përsa i përket ndonjë dështimi nga ana e vetë për të kryer ndonjë prej detyrimeve e veta, në përputhje me Rregullat e Tregtisë, në qoftë se një Ngjarje Force Madhore pengon kryerjen e detyrimeve të saj përkatëse.

## 11. DËMSHPËRBLIMET

11.1 Anëtari do të dëmshpërblejë plotësisht dhe në mënyrë efektive Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike prej dhe kundrejt çdonjërit dhe të gjitha kostove, ankesave, dëmtimeve dhe shpenzimeve që rrjedhin direkt nga çdo shkelje e detyrimeve të veta, në përputhje me Rregulloren e Tregtisë, me kusht që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të lehtesuar kosto, dëmtime e shpenzime të tilla, pa paragjykim për detyrimet e tij ndaj Anëtarëve të tjerë dhe të drejtën e tij për të mbrojtur integritetin e çdo Tregu Fizik.

11.2 Çdo anëtar është i detyruar të dëmshpërblejë plotësisht të gjitha kostot të cilat mund të lindin për Bursen Shqiptare të Energjisë Elektrike në lidhje me TVSH-në, taksat doganore, kapacitetet ndërkufitare apo pagesa të tjera të ngjashme për energjinë elektrike, e cila është tregtuar në Tregun Shqiptar të një Dite më Parë, pasi këto kosto janë përgjegjësi vetëm e Anëtarit në fjalë.

## 12. SHËRBIMET E INFORMACIONIT TË TREGUT

### 12.1 Të Drejtat pronësore kundrejt informacionit të Transaksionit

12.1.1. Kurdo që një Anëtar ofron të dhëna në formën e Porosive ose të tjera për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike nëpërmjet STE ose STT, të dhënat e tilla do ti përkasin Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike. E drejta e autorit dhe të gjitha të drejtat tjera të pronësisë intelektuale ose të drejta ekskluzive të çfarëdo natyre të përfshira në Informacionin e Transaksionit (duke përfshirë, për shmangien e dyshimit, të gjitha të drejtat e bazës së të dhënave dhe të drejtat e ngjashme nëse janë apo jo të mbrojtura me ligj), që rrjedhin nga Tregtia janë dhe do të mbeten në çdo kohë, ndërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike dhe Anëtarit, pronë e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike ose e licencuesve të saj.

12.2 **Prezantimi**

12.2.1 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të ketë të drejtën të përdorë, kopjojë, përshtasë, autorizojë, furnizojë, shpërndajë, shesë, emërojë, transferojë, paguajë qira, kontraktojë për qira, caktojë pagesë ose gjithashtu manaxhojë Informacionin e Transaksioneve dhe informacione të tjera në lidhje me çështjet teknike dhe financiare, I papenguar nga çdo detyrë konfidencialiteti kundrejt çdo anëtari, për aq kohë sa që ky informacion nuk identifikon asnjë anëtar individual. Anëtarët nuk do të kenë të drejtën e shpërblimit në lidhje me aktivitete të tilla.

12.2.2 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund të kalojë Informacione te Autoritetet publike dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit, nëse kështu kërkohetnga legjislacioni në fuqi. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të informojë Anëtarin për këtë dispozitë të informacionit për aq sa është e lejuar për ta bërë këtë, në bazë të ligjit në fuqi apo rregullores.

12.2.3 Krahas dispozitave të këtij Neni 12.2, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka të drejtë të japë informacion, siç është përcaktuar në Rregullat e Drejtimit të Tregut.

## 13. KOMUNIKIMET

13.1 Komunikimet me shkrim ndërmjet Anëtarëve dhe Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike mund të jenë në Anglisht, nëse një gjë të tillë kërkon Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike.

13.2 Çdo njoftim që jepet në bazë të Rregullores së Tregtimit do te bëhet me shkrim dhe do të dorëzohet ose dërgohet me letër ose e-mail në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike në adresat dhe numrat e specifikuara në faqen e saj në çdo kohë (nëse I drejtohet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike) ose në adresën përkatëse apo numrin e telefonit ose adresën e e-mail-it, e specifikuar në Marrëveshjen e saj të Tregtimit ose siç njoftohet ndryshimi I konfirmuar nga Bursa Shqiptare e Energjisë.). Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike mund gjithashtu të komunikojë në përgjithësi me Anëtarët nëpërmjet faqes së vetë të internetit: www.albanianpowerexchange.com.

13.3 Lajmërimet do të konsiderohen se janë dhënë (në rastin e komunikimit me e-mail), në datën në të cilën ato janë të dërguar, ose (në rastin e komunikimeve të tjera) në datën e dorëzimit në adresën e duhur.

13.4 Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike do të ketë të drejtë të veprojë gjithashtu të besojë mbi çdo komunikim (nëse ky është me shkrim apo jo) I cili ka sens dhe në të cilin Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka besim:

a. Ta lëshojë nga ose në emër te Anëtarit; ose

a. Të ketë qenë aprovuar nga një individ I cili është autorizuar nga ai Anëtar, dhe I cili (në rastin e një komunikimi elektronik) kënaq kërkesat e çfarëdo kërkese në fuqi të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në lidhje me sigurinë dhe integritetin e informacionit, që transmetohet në mënyrë elektronike.

## 14. SHTESAT

14.1 Rregullat e Tregtimit mund të amendohen nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike dhe të bëhen publike me një njoftim minimumi katërmbedhjetë (14) ditor.

14.2 Amendime për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, mundet të hyjnë në fuqi vetëm duke ndjekur konsultimet me Bordin Keshillimor të Konsumatoreve dhe me aprovimin e ERE-s.

14.3 Pavarësisht nga nenet 14.1 dhe 14.2, ndryshimet në Rregulloren e Tregtimit mund të zbatohen me efekt të menjëhershëm në vijim të njoftimit për anëtarët e ndikuar:

a. Nëse kështu kërkohet nga Ligji në Fuqi;

b. Nëse të tilla amendime janë të domosdoshme për opinionin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike si për vazhdimin e operacioneve të Tregtimit apo për integritetin e Tregut përkatës Fizik;

c. Nëse kështu kërkohet në mënyrë për të lehtësuar fillimin e një ose më shumë produkteve të reja, me kusht që ndryshimet e tilla nuk ndikojnë drejtpërdrejt në Tregtinë në (ose Pagesën e) Produkteve të tjera dhe me kusht që Bordi Keshillimor i Konsumatoreve ka rënë dakord me amendime të tilla;

d. Nëse amendime të tilla janë të domosdoshme për të korrektuar gabimet në Rregullat e Tregtimit; apo

e. Nëse amendime të tilla janë vetëm me natyrë redaktuese dhe nuk sjellin ndonjë ndryshim thelbësor në Rregulloren e Tregtimit, duke përfshirë edhe sqarimet dhe ndryshimet në paraqitjen etj.

## 15. TË NDRYSHME

### 15.1 Transferimi I të Drejtave

Të drejtat që Rregullat e Tregtimit i garantojnë një Anëtari, nuk janë të transferueshme apo të tjetërsueshme pa aprovimin paraprak me shkrim të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.

### 15.2 Ndarshmëria (pjesëzimi)

Nëse në çdo kohë ndonjë dispozitë e Rregullave Tregtimit bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme në çdo aspekt në bazë të ligjit të çdo juridiksioni, as

ligjshmëria, vlefshmëria ose zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të Rregullave të Tregtimit, as ligjshmëria, vlefshmëria ose zbatueshmëria e nje dispozite të tillë, sipas ligjit të çdo juridiksioni tjetër, nuk do të mundet në asnjë mënyrë të preket ose të dëmtohet në këtë mënyrë.

15.3 **Të drejtat e mos-dorëheqjes**

Asnjë dështim i një pale për të ushtruar, as ndonjë vonesë nga ana e saj në ushtrimin, e çdonjërës prej të drejtave të veta (në tërësi ose pjesërisht) sipas Rregullores së Tregëtisë, s'do të veprojë si një heqje dorë nga të drejtat apo mjetet juridike të palës mbi atë rast, apo ndonjë rast të mëvonshëm.

## 16. LIGJI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

16.1.1 Këto Rregulla Tregtimi, të gjitha Transaksionet, Shlyerjet dhe Pagesat që kryhen nën to, dhe gjithe obligimet jo-kontraktuale që ngrihen nga ose në lidhje me to, do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me Legjislacionin shqiptar.

16.1.2 Gjykatat Shqiptare do të kenë juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çdo ankesë, mosmarreveshje apo diferencë që mund të dalë nga/ose në lidhje me këto Rregulla Tregtimi, përfshirë çdo pyetje përsa i përket ekzistencës, vlefshmërisë apo përfundimit të tyre.

16.1.3 Çdo Anëtar dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në mënyrë të parevokueshme heqin dorë nga çdo vërejtje që mund të kenë aktualisht apo në të ardhmen, për vendodhjen e çdo procedure në gjykatat shqiptare dhe çdo pretendim që çdo procedurë kanë sjellë në një forum të papërshtatshëm, dhe më tej në mënyrë të parevokueshme pranon se një gjykim në çdonjë procedim të sjellë në gjykatat shqiptare, do të jetë përfundimtar dhe detyrues mbi këtë Palë dhe mund të zbatohet në gjykatat e çdonjë juridiksioni tjetër në përputhje me ligjet e zbatueshme të atij juridiksioni. Each Member and Albanian Power Exchange irrevocably waives any objection which it may have now or hereafter to the laying of the venue of any proceedings in the Albanian courts and any claim that any such proceedings have been brought in an inconvenient forum, and further irrevocably agrees that a judgment in any proceedings brought in the Albanian courts shall be conclusive and binding upon such Party and may be enforced in the courts of any other jurisdiction in accordance with the enforcement laws of that jurisdiction.

16.1.4 Çdo Anëtar dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në mënyrë të parevokueshme heqin dorë nga çdo e drejtë për të kërkuar një shërbim apo proces në ndonjë procedurë që nuk është kryer si duhet, ku shërbimi i tillë i procesit është kryer nëpërmjet dorëzimit në adresën e fundit të njoftuar nga ana e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sipas nenit 13 të kësaj rregullore.